UDHËZIM
Nr. 21, datë 8.9. 2023

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E KLASAVE TË ARSIMIT TË ORIENTUAR NË SHKOLLAT E ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 22, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR KRIJIMIN E KLASAVE TË ARSIMIT TË ORIENTUAR NË SHKOLLAT E ARSIMIT BAZË

1. Në shkollat e arsimit bazë mund të krijohen klasa të arsimit të orientuar, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Shkollat e arsimit bazë, ku krijohen klasa të arsimit të orientuar, duhet të plotësojnë kushtet infrastrukturore, personelin mësimor të specializuar, si dhe bazën materiale dhe didaktike të nevojshme për zhvillimin e mësimit në klasën e arsimit të orientuar, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Nxënësit që pranohen në klasat e arsimit të orientuar të arsimit bazë, kurrikulën e përgjithshme e zhvillojnë të përbashkët me nxënësit e tjerë, ndërsa lëndët e specialitetit i zhvillojnë të veçanta.
4. Plani mësimor i këtyre klasave në arsimin bazë, miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin.
5. Programet mësimore të lëndëve të specialitetit për klasat e arsimit të orientuar në arsimin bazë, hartohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin.
6. Norma mësimore për mësuesit e lëndëve të specialitetit përcaktohet sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin, për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar.
7. Shkollat e arsimit bazë ku krijohen klasa të arsimit të orientuar miratohen nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP), pas propozimit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.
8. Kërkesat për pranimin e nxënësve në klasat e arsimit të orientuar bëhen në shkollën përkatëse nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore për nxënësin.
9. Kriteret e pranimit të nxënësve në klasat e arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë dhe dokumentacioni përcaktohen nga shkolla përkatëse dhe miratohen nga ZVAP-i.

KREU II
PROCEDURAT PËR KRIJIMIN E KLASAVE TË ARSIMIT TË ORIENTUAR ME DREJTIM ARTISTIK NË SHKOLLAT E ARSIMIT BAZË

1. Pranimi i nxënësve në klasat e arsimit të orientuar me drejtim artistik në shkollat e arsimit bazë bëhet me konkurs.
2. Konkursi për pranimin e nxënësve në klasat e arsimit të orientuar me drejtim artistik në shkollat e arsimit bazë zhvillohet sipas datave të përcaktuara nga ZVAP-i. Datat e konkursit afishohen në një vend të dukshëm të shkollës dhe publikohen në faqet e internetit të shkollës dhe të ZVAP-it.
3. Përzgjedhja e nxënësve për klasat e orientuara me drejtim artistik në shkollat e arsimit bazë bëhet nga komisioni i ngritur nga drejtori i shkollës.
4. Komisioni i përzgjedhjes përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, përkatësisht 1 (një) mësues që mbulon lëndën e specialitetit në shkollë, 1 (një) mësues i përcaktuar nga ZVAP-i që mbulon lëndën e

specialitetit përkatës në një shkollë tjetër brenda juridiksionit të ZVAP-it dhe 1 (një) përfaqësues i ZVAP-it.

5. Komisioni afishon në shkollë dhe në faqen e saj të internetit listën e fituesve, jo më vonë se 1 (një) ditë pas zhvillimit të konkursit. Lista firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Procesi i konkurrimit monitorohet nga DRAP-i.

6. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore për nxënësin gëzon të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

7. Në përfundim të procesit të konkursit, komisioni harton procesverbalet përkatëse, të cilat administrohen në drejtorinë e shkollës.

KREU III
PROCEDURAT PËR KRIJIMIN E KLASAVE TË ARSIMIT TË ORIENTUAR TË PROFILIZUARA NË SPORT NË SHKOLLAT E ARSIMIT BAZË

1. Klasat e arsimit të orientuar të profilizuara në sport krijohen në disiplina të ndryshme sportive, sipas kërkesave të nxënësve.

2. Krijimi i klasave të profilizuara në sport, referuar elementeve bazë teknike dhe fizike të nxënësve, bëhet pas përfundimit të arsimit fillor (AF), mbështetur në kërkesën e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për to.

3. Krijimi i klasës së profilizuar në sport nis nga klasa VI, për të vijuar në vitet në vazhdim deri në klasën IX.

4. Klasat e profilizuara në sport krijohen në një disiplinë të vetme sportive ose në dy disiplina sportive të kombinuara (djemtë në një disiplinë, vajzat në disiplinën tjetër).

KREU IV
DISPOZITAT E FUNDIT

1. Procedurat e pranimit të nxënësve në klasat e arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë janë objekt i inspektimit dhe i vlerësimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi